

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dua Lipa reagon pas vendimit në Hagë! "Liria është fitu me gjakun e dëshmorëve..." Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/dua-lipa-reagon-pas-vendimit-ne-hage-liria-eshte-fitu-me-gjakun-e-deshmoreve/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 14:02:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 13:59:59 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6343fa70cdafc54563e6136efea5a2341157f085b8145b5da7bd12aa34c79675
TEKSTI	38e834e4782d64da211263b933b25e6616815e2c370e1907cc0e25864f5de7b6
PAMJA	513953e490312bef2785116b969fef01eee2406d51c161dcf5e2a6d86e5fe280

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5b0b97f469bbd7627220b7f77b7d00aee366f0bb921757fa3723b256ac8476a6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	dc0b234c87b6bef6f484ef22e44d5789ea8bfa692c7eb14dae36a548c590e2a2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5b0b97f469bbd7627220b7f77b7d00aee366f0bb921757fa3723b256ac8476a6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Celebrities Gossip Showbiz

Dua Lipa reagon pas vendimit në Hagë! “Liria është fitu me gjakun e dëshmorëve...”



Redaksia K

17 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Dua Lipa ka reaguuar në rrjetet sociale pas aktgjykimit të shpallur në Hagë ndaj katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Këngëtarja me famë botërore ka shpërndarë në Instagram disa postime të publikuara fillimisht nga babai i saj, Dukagjin Lipa, duke rikthyer në vëmendje sakrificën e luftës së Kosovës dhe figurën e UÇK-së.

Në njërin prej postimeve shfaqet emblema e UÇK-së, e shoqëruar me mesazhin “Liria ka emër”.

Ndërsa në një tjetër postim, të shpërndarë nga Dua, thuhet:

“Liria është fitu me gjak, me gjakun e dëshmorëve që dhanë jetën për liri. Askush nuk ka të drejtë ta njollojë luftën për liri. Askush nuk ka të drejtë të njollojë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe idealin e mijëra të rinjve e të rejave për lirinë që gëzojmë sot. UÇK është dhe gjithmonë do të mbetet simbol i lirisë dhe pavarësisë sonë. Liria ka emër.

Krahas këtyre mesazheve, në Instagram është shpërndarë edhe një material që rendit shifra mbi pasojat e luftës në Kosovë, duke përmendur 1 milion refugjatë, 11 mijë të vrarë, 1,024 fëmijë të vrarë, 20 mijë viktima të dhunës seksuale dhe 1,600 persona ende të pagjetur.

Reagimi i **Dua Lipës** erdhi më 16 shtator, në ditën kur Dhomat e Specializuara në Hagë shpallën aktgjykimin e shkallës së parë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Sipas aktgjykimit të raportuar nga mediat, Thaçi dhe Krasniqi u dënuan me nga 25 vjet burgim, Veseli me 18 vjet, ndërsa Selimi me 13 vjet. Vendimi është i shkallës së parë dhe mund të apelohej.

Dua Lipa nuk ka publikuar një deklaratë të gjatë që analizon vendimin gjyqësor. Ajo ka zgjedhur të përcjellë përmes Instagramit mesazhe dhe materiale që lidhen me luftën e Kosovës, dëshmorët dhe UÇK-në.

Reagimi i saj vjen në një ditë kur vendimi në Hagë ka sjellë reagime të shumta në Kosovë dhe në mesin e figurave publike shqiptare, duke rikthyer në qendër të debatit historinë e luftës dhe kujtesën për viktimat dhe të zhdukurit.

LAJME TË NGJASHME



Pagat e magistratëve, rrezohet kërkesa e PD-së për tërheqjen e draftit të PS-së!
1 MIN



Pas vendimit në Hagë, reagon Rita Ora! “Duke luftuar për Kosovën që sot...”
1 MIN



Blero shpërthen pas vendimit në Hagë! “Sot na dënuan të gjithëve...”



Dënimi i ish-liderëve të UÇK, reagon Mbretëria e Bashkuar: Të mos nëndoret në të nxitur tensione



Reagon djali i Jakup Krasniqit pas dënimit me 25 vite burg: Sano takova babanë. më tha...

MË TË LEXUARAT



Të paguhesh për të lexuar, kjo po ndodh në Singapor!



Papa Leoni XIV paralajmëron për rrezikun e Inteligjencës Artificiale!



Majko përlohet pas vendimit për ish-liderët e UÇK: Dramë njerëzore e jashtëzakonshme, mund të cenojë historinë!



Lorenc Hasrama: "Kam zgjedhur të jap më të mirën, festivalet..."



Nga Guardian te Reuters dhe Al Jazeera, çfarë shkruajnë mediat ndërkombëtare për vendimin e Gjykatës së Hagës për liderët e UÇK-së



Vendimi i gjykatës së Hagës, qytetarët me lot në sy: Nuk ia vlen të jetosh kur vendi yt shkatërrohet



Ky është monoliti më i madh në Afrikë dhe një nga më të mëdhenjtë në botë...



Sot verdikti i Hagës/ Konjufca: Presim vetëm një vendim, lirin e katër ish-krerëve të UÇK-së



Charles Smith kryeson trupin gjykues në Hagë



Trupi gjykues: Të katërt ish-anëtarët e UÇK-së penalisht përgjegjës për krime lufte

EDITORI SUGJERON



"Prej pesë vitesh duam një fëmijë..." / Çiljeta Xhilaga zbulon planet me Albanin: Kam menduar të bëj in vitro!



"Të kisha çerekun e egrove të kolegeve të mia..." / Çiljeta Xhilaga: Nuk kam vuar për vëmendje!



10 shenjat që tregojnë se ushqimi duhet të hidhet para se të...



Pjeshkat apo bananet?! Cili frut është më i mirë për sheqerin në gjak dhe kaliumin...



10 pjesët më të mira të mishit të viçit për proteina me pak yndyrë!



Pilula eksperimentale imiton hormonin që prodhohet gjatë aktivitetit fizik intensiv!



Çfarë nuk duhet të mungojë në dietën tuaj për flokë të shëndetshëm...



Lorenc Hasrama risjell këngën e Flori Mumajesit live në studio!



Lorenc Hasrama kujton situatën më qeshake që i ka ndodhur në koncert!



Cili ka qenë përfaqësimi më i mirë në "Eurovision" sipas Lorenc Hasramës...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

[Kontakti](#)
[Marketing](#)
[Frekuencat](#)
[Aksesueshmëria](#)
[Mundësi Punësimi](#)
[Privacy Policy & Terms](#)

JavaScript is required for [tabnav widget](#) to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.